

**VENDIM**  
**Nr. 277, datë 16.5.2018**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.395, DATË 29.4.2015, TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE**  
**TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHETËTËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA**  
**PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 395, datë 29.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Kudo në vendim, emërtimi “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë”, zëvendësohet me “Ministria përgjegjëse për rininë”.

2. Pikat 11/1 dhe 11/2 ndryshohen si më poshtë vijon:

“11/1. Ministria përgjegjëse për rininë administron procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjet e radhës, për çdo institucion të administratës shtetërore, deri në 200 praktikantë në çdo vit buxhetor, bazuar në kërkesat e institucioneve për punësimin e praktikantëve për 1 (një) vit kalendarik dhe numrin e praktikantëve që kanë kryer me sukses programin kombëtar të praktikave të punës.

11/2. Ministria përgjegjëse për rininë dërgon në ministrinë përgjegjëse për financat numrin e praktikantëve që do të punësohen në çdo institucion të administratës shtetërore, në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës për çdo vit buxhetor. Ministria përgjegjëse për financat njofton degët e thesarit për numrin e praktikantëve që do të paguhën brenda fondeve të miratuara për institucionin përkatës në ligjin vjetor të buxhetit.”.

3. Pika 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“13. Praktikantët e punësuar, për efekt pagese, klasifikohen jo më lart se niveli i specialistit të kategorisë IV-b. Fondet e nevojshme financiare për zbatimin e pikave 11/1 dhe 11/2, të këtij vendimi, përballohen nga fondet e buxhetit të miratuara për institucionet e administratës shtetërore për shpenzimet e personelit, për vitin përkatës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Senida Mesi**